

MIRATOHET

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si autoriteti përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelleje që nxit diskriminimin;

Duke vlerësuar zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;

Duke synuar forcimin e mekanizmave institucionalë të barazisë në shoqëri dhe rolin e tyre për funksionimin e një shoqërie demokratike, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, pa diskriminim dhe intolerancë;

Duke mbështetur e nxitur bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera në nivel qendror e vendor, me shoqërinë civile, medien dhe publikun;

Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2023 në këto drejtime:

Realizimin e studimit “Ndikimet e kornizës ligjore dhe praktikës së administratës publike tek barazia gjinore në elementët familjarë”.

Angazhimin në zonat rurale për të nxitur respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përfshirë minoritetet rome dhe egjiptiane, të moshuarit, njerëzit me probleme të shëndetit mendor, njerëzit me aftësi të kufizuara, veçanërisht gratë dhe vajzat që u përkasin këtyre grupeve.

Angazhimin në dhënien e rekomandimeve drejtuar autoriteteve përkatëse për propozime për ndryshime ligjore apo projektligje të reja.

Intensifikimin e aktivitetit ndërgjegjësues përmes përdorimit të medias dhe formave të reja të komunikimit virtual, me qëllim nxitjen e respektimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Rritjen e aktivitetit ndërgjegjësues të zyrave rajonale për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi.

Rritjen e numrit të çështjeve të trajtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2024 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të dorëzojë pranë Kuvendit një raport analitik në lidhje me shkaqet kryesore të rritjes së ankesave, si dhe për format e diskriminimit.

2. Të konkretizojë bashkëpunimin me Avokatin e Popullit sipas një kalendari të përcaktuar aktivitetesh ndërgjegjësuese në sistemin arsimor të ulët dhe të mesëm për adresimin e shkaqeve të diskriminimit dhe ndërgjegjësimin kundër gjuhës së urrejtjes.

3. Të intensifikojë aktivitetin për adresimin e shkaqeve të diskriminimit dhe ndërgjegjësimin kundër gjuhës së urrejtjes tek fëmijët duke rritur numrin e çështjeve të trajtuara *ex officio* (çështje të nisura me iniciativën e KMD-së) për bullizmin në shkolla.

4. Të monitorojë zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, me fokus të veçantë garantimin e përdorimit të shërbimeve cilësore shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar, kryesisht në zonat rurale, dhe të informojë Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në lidhje me gjetjet e këtij monitorimi, jo më vonë se muaji dhjetor 2024.

5. Të angazhohet në propozimin e ndryshimeve ligjore “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me qëllim fuqizimin e rolit të Komisionerit për të lëshuar urdhra ekzekutivë në vend të rekomandimeve.

6. Të rrisë angazhimin për të monitoruar procesin e përdorimit teknologjik për disa shërbime publike bazë arsimore, sociale, etj., për të vlerësuar nëse ka rezultuar diskriminues tek shtresat në nevojë dhe ato në kushte vështirësie ekonomike.

7. Në bashkëpunim me AMA-n të angazhohet për përgatitjen e një plani masash me qëllim parandalimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe të dhunës në mediet online.

8. Të angazhohet në adresimin në mënyrë proaktive të rasteve të bullizmit në sistemin arsimor dhe të intensifikojë aktivitetin ndërgjegjësues mes të rinjve përmes përdorimit të formave të reja të komunikimit virtual, me qëllim nxitjen e respektimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

9. Të angazhohet në realizimin e takimeve ndërgjegjësuese me grupet e interesit për gjuhën e dhunës dhe diskriminimin.

10. Të informojë periodikisht Kuvendin për statusin e zbatimit të rekomandimeve, sipas përcaktimeve në vendimin e Kuvendit nr. 134/2018 “Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik”.

Miratuar në datën 26.7.2024